



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.181**

**dhjetor**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.896, datë 21.12.2011	Për një shtesë në vendimin nr.165, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Maminas të qarkut të Durrësit”.....	10157
Vendim i KM nr.907, datë 21.12.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Nishan” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë .....	10158
Vendim i KM nr.912, datë 23.12.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.117, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash”.....	10158
Vendim i KM nr.913, datë 21.12.2011	Për nxjerrjen nga qarkullimi të pasaportave jobiometrike përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë.....	10159
Vendim i KM nr.914, datë 21.12.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar.....	10160
Vendim i KM nr.915, datë 28.12.2011	Për miratimin e kalendarit të vitit 2012 për menaxhimin e shpenzimeve publike.....	10160
Vendim i KM nr.916, datë 28.12.2011	Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore.....	10162

Vendim i KM nr.918, datë 28.12.2011	Për përcaktimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për periudhën 1 janar-15 qershor 2012 dhe 15 shtator-31 dhjetor 2012, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.....	10166
Vendim i KM nr.924, datë 14.12.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, për vitin akademik 2011-2012”.....	10167
Urdhër i MASH nr.483, datë 3.10.2011	Për hapjen e Fakultetit Ekonomik në shkollën e lartë private “Illyria”.....	10173
Urdhër i MASH nr.485, datë 3.10.2011	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programeve të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave”, si dhe hapjen e Fakultetit të Shkencave Humane të Zbatuara të Edukimit në shkollën e lartë private “Justicia”.....	10173
Urdhër i MASH nr.487, datë 4.10.2011	Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca politike”, të institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e lartë “Illyria””.....	10174
Urdhër i MASH nr.488, datë 4.10.2011	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Inxhinieri mekatronike” në shkollën e lartë universitare private “Albanian University”.....	10175
Vendim i ERE nr.162, datë 30.12.2011	Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët tariforë të lidhur në tension të lartë.....	10176
Vendim i BSH nr.82, datë 14.12.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”.....	10177
Vendim i ERRU nr.32, datë 14.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Lezhë.....	10180
Vendim i ERRU nr.33, datë 14.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Mirditë.....	10181
Vendim i ERRU nr.34, datë 14.12.2011	Për licencim për herë të parë “Ndërmarrja ujësjellës Malësia e Madhe” sh.a.....	10181
Vendim i ERRU nr.35, datë 14.12.2011	Për rinovim licence “Ujësjellësi fshat sh.a. Lushnjë”.....	10182
Vendim i ERRU nr.36, datë 19.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Durrës.....	10182
Vendim i ERRU nr.37, datë 19.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Shkodër.....	10183

Vendim i ERRU nr.38, datë 21.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Gjirokastrë qytet.....	10183
Vendim i ERRU nr.40, datë 22.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Tiranë.....	10184
Vendim i ERRU nr.42, datë 23.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. “Ujësjellës Bilishtë”.....	10185
Vendim i ERRU nr.43, datë 23.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Korçë.....	10185
Vendim i ERRU nr.44, datë 23.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. “Ujësjellës Elbasan fshat”.....	10186
Vendim i ERRU nr.45, datë 26.12.2011	Për miratimin e tarifës së shitjes së ujit me shumicë (komunës Dropull i Poshtëm) për sh.a. “Ujësjellës Gjirokastrë Fshat”.....	10187
Vendim i ERRU nr.46, datë 26.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. “Ujësjellës Orikum”.....	10187
Vendim i ERRU nr.47, datë 26.12.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. “Ujësjellës Shkodër Fshat”.....	10188
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetases Neriman Karagjozi.....	10188

**VENDIM**  
**Nr.896, datë 21.12.2011**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.165, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË  
KOMUNËS MAMINAS, TË QARKUT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Maminas, të qarkut të Durrësit, listë e cila do t'i shtohet listës përfundimtare që i bashkëlidhet vendimit nr.165, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave.

Lista shtesë me 1 (një) fletë, e cila përfundon me numrin rendor 2 (dy), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Maminas e qarkut të Durrësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Maminas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
122-123	Pyll prodhues	Pronësi

**2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE**  
(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta, të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)  
Për një shtesë në listën përfundimtare të transferimit të pyjeve dhe kullotave, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave me nr.165, datë 13.2.2008

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Tiranë Komuna: Maminas Fusha e përdorimit të pronës: pyje										
Nr. Rend.	Nr. i pasurisë Sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosores (EPK)	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sip. në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, entiteti me përgjegjësi administrative	Instituti, entiteti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	122	Fshati Rubjeka, Kareç etj.	Gryka e Kënetës	62 (10)	Pyll prodhues	26.04	Lëndë dru zjarri	MMPAU	DSHP	Kaluar komunës në vitin 2004
2	123	Fshati Rubjeka, Kareç etj.	Gryka e Gërdecit	67b (18b)	Pyll prodhues	3.83	Lëndë dru zjarri	MMPAU	DSHP	Kaluar komunës në vitin 2004
						29.87				



**VENDIM**  
**Nr.907, datë 21.12.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “NISHAN” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË  
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Nishan” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “F&L”, sh.p.k., për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Nishan”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.912, datë 23.12.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.117, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I  
SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr.117, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 83 532 200 (tetëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, zëri “Shpronësime”, për vitet 2009-2010.”.

2. Fondi prej 83 532 200 (tetëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind) lekësh, që i përket llogarisë së veçantë të Ministrisë së Financave “Fondi i shpronësimeve”, të përdoret për përballimin e shpronësimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për segmente të tjera rrugore nacionale, ku është parashikuar përballimi i shpronësimit po nga ky fond, për të cilat procesi i likuidimit për efekt shpronësimi nuk është përfunduar deri në këto momente.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.913, datë 21.12.2011**

**PËR NXJERRJEN NGA QARKULLIMI TË PASAPORTAVE JOBIOMETRIKE PËRPARA  
MBARIMIT TË AFATIT TË VLEFSHMËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të parë të nenit 9 të ligjit nr.10 306, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasaportat jobiometrike do të jenë të vlefshme si dokument udhëtimi deri në datën 1 mars 2012.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr.914, datë 21.12.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.313, DATË 1.7.2002 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE  
SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË BASHKISË DHE KOMUNËS”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në lidhjen, që i bashkëlidhet vendimit nr.313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në pikën 7 të kreut XXXIV, të bëhen këto ndryshime:

1. Numri maksimal i punonjësve të policisë së komunës, për komunën Farkë, të bëhet 8 (tetë) veta.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1 097 (një mijë e nëntëdhjetë e shtatë) veta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.915, datë 28.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË VITIT 2012 PËR MENAXHIMIN E  
SHPENZIMEVE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kalendarit të vitit 2012 për menaxhimin e shpenzimeve publike, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Integritimit, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, si dhe fondet speciale të tyre për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2012.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**KALENDARI I MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE 2012**

<b>Periudha</b>	<b>Data</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Veprimi përkatës</b>
Dhjetor 2011	21	MF	Përgatit dhe paraqet në KPS kalendarin e MSHP-së.
Dhjetor 2011	28	KPS/KM	Shqyrton dhe miraton kalendarin e MSHP-së.
Janar	9	MF	Paraqet në KPS raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike dhe buxhetore.
Janar	11	KPS/KM	Miraton raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike dhe buxhetore (RVPMB). KM miraton RVPMB.
Janar	25	KM	Shqyrton dhe miraton programin EFP.
Shkurt	1	DEBASKON	Paraqet në KPS për diskutim dhe miratim politikat prioritare me ndikim në tavanet e përgatitjes së PBA-së.
Shkurt	1	MF	Paraqet në KPS për shqyrtim dhe miratim tavanet e përgatitjes së PBA-së.
Shkurt	8	KM	KPS dërgon për miratim në KM tavanet e përgatitjes së PBA-së.
Shkurt	15	KM	Paraqet për informacion RVPMB dhe tavanet në Kuvend.
Shkurt	17	MF	Dërgon udhëzimin e përgatitjes së buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
Shkurt-prill	17 shkurt-27 prill	Njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore.
Prill	30	Njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre	Paraqesin në MoF kërkesat e tyre buxhetore.
Maj	1-18	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave buxhetore.
Maj	21-31	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore
Qershor	5	MF	Dorëzon për miratim në KPS parashikimin e përditësuar makro.
Qershor	11	KPS/KM	Miraton parashikimin e përditësuar makro.
Qershor	1-14	MF	Përgatit dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së.
Qershor	18	MF	Paraqet dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA për shqyrtim dhe miratim në KPS.
Qershor	29	KPS/KM	Miraton dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së.
Korrik	9	MF	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
Korrik	26	MF	I paraqet Kuvendit për informacion vendimin e miratuar të dokumentit të PBA-së.
Korrik-gusht	11 korrik-30 gusht	Njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre	Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore.
Gusht	31	Njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre	Paraqesin në MoF kërkesat e rishikuara buxhetore.
Shtator	3-14	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore.





Shtator	17-28	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore.
Tetor	5	MF	Paraqet në KM parashikimin e përditësuar makro.
Tetor	11	KPS/KM	Miraton parashikimin e përditësuar makro.
Tetor	19	MF	Përgatit dokumentin e rishikuar të PBA-së, projektbuxhetin vjetor dhe i paraqet për shqyrtim në KPS.
Tetor	24	KPS/KM	Miraton projektbuxhetin vjetor dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së.
Tetor	31	KM	I paraqet Kuvendit projektbuxhetin vjetor dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së.

**VENDIM**  
**Nr.916, datë 28.12.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME,  
PËR VITIN 2012, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore, është 415 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përfundimisht, për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, për 10 (dhjetë) punonjës arkivistë në aparatën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për 5 (pesë) punonjës në sektorin e pagesave dhe dëshmipërblimeve, në Ministrinë e Financave, nuk zbatohet pika 3 e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

3. Përfundimisht për punonjës të kontraktuar nga Instituti i Statistikave, të cilët do të merren me anketimet, miratimi i numrit të tyre, afatet kohore dhe specifikime të tjera të përcaktohen nëpërmjet një udhëzimi të përbashkët ndërmjet INSTAT-it dhe Ministrisë së Financave.

4. Përfundimisht për qendrat e transferimit të teknologjisë në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për shkak të veçorisë së punës, pagesa e punonjësve të kontraktuar përllëgaritet sipas volumit të punës së kryer dhe paguhet sipas preventivit përkatës.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2012, për njësitë e qeverisjes qendrore. Përfundimisht për ALUIZNI-n, QTTB-të dhe 20 (njëzet) punonjës të SHISH-it, efektet financiare të përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit. Efektet financiare për pozicionet e kontraktuara për periudhën kohore vjetore fillojnë më 1 janar 2012.

6. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet buxhetore sipas lidhjes nr.1, të përmendur në

pikën 1 të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
<b>04</b>	<b>Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës</b>	<b>33</b>			
	Aparati	10	Arkiviste	8 orë	vjetore
	Aparati	1	Pastruese	4 orë	vjetore
	Reparti i Inspektim-Shpëtim Miniera	2	Nëpunës rojë	6 orë	vjetore
	Reparti i Inspektim-Shpëtim Miniera	3	Punëtor shpimi	6 orë	vjetore
	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	3	Punëtor shpimi	6 orë	vjetore
	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (në rrethe)	10	Nëpunës rojë	6 orë	vjetore
	Inspektorati Qendror Teknik	1	Punonjës pastrimi	6 orë	vjetore
	Inspektorati Qendror Teknik	1	Punonjës i mirëmbajtës	4 orë	vjetore
	Qendra Kombëtare e Regjistrimit	2	Operatorë	6 orë	vjetore
<b>05</b>	<b>Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit</b>	<b>166</b>			
	QTTB në Vlorë, Lushnjë, Korçë, Shkodër, nga ku:	150	Punëtorë blegtorie/fushe/mekanizator/rojë e bazës eksperimentale		
	QTTB Vlorë	16	Punëtor	8 orë/ditë	Vetëm periudha pik
	QTTB Vlorë	6	Punëtor baza prodhuese (punëtor mirëmbajtës)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Vlorë	8	Punëtor fushe (punëtor mirëmbajtës)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Vlorë	4	Rojë baza eksperimentale (nëpunës informacioni)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Lushnjë	9	Punëtor	8 orë/ditë	Vetëm periudha pik
	QTTB Lushnjë	15	Punëtor fushe punëtor mirëmbajtës)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Lushnjë	5	Rojë baza eksperimentale (nëpunës informacioni)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do



					të paraqitet
	QTTB Korçë	5	Punëtor	8 orë/ditë	Vetëm periudha pik
	QTTB Korçë	12	Punonjës blegtorie	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Korçë	12	Punëtor fushe (punëtor mirëmbajtës)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Korçë	5	Mekanizator (teknik i mesëm)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Shkodër	6	Punëtor	8 orë/ditë	Vetëm periudha pik
	QTTB Shkodër	6	Rojë baza eksperimentale (nëpunës informacioni)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Shkodër	6	Punëtor fushe (punëtor mirëmbajtës)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Fushë-Krujë	5	Punëtor	8 orë/ditë	Vetëm periudha pik
	QTTB Fushë-Krujë	11	Punëtor fushe (punëtor mirëmbajtës)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Fushë-Krujë	5	Roje baza eksperimentale (nëpunës informacioni)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Fushë-Krujë	11	Mekanizator (teknik i mesëm)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	QTTB Fushë-Krujë	3	Punëtor të bazës eksperimentale (punëtor mirëmbajtës)	8 orë/ditë	12 muaj periodikisht sipas preventivit që do të paraqitet
	Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve	12	Punëtor fushe	4 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve	1	Teknikë	4 orë/ditë	vjetore
	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve	3	Teknikë	4 orë/ditë	vjetore
<b>06</b>	<b>Ministria e Punëve Publike dhe Transportit</b>	<b>150</b>			
	ALUIZNI, nga ku:	150	Specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Zyra Qendrore e ALUIZNI-t Tiranë	10	Specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Zyra Rajonale e ALUIZNI-t Tiranë	50	Specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Zyra Rajonale e ALUIZNI-t Durrës	20	Specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Zyra Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan	10	Specialistë/	8 orë/ditë	vjetore

			ndihmës specialistë		
	Zyra Rajonale e ALUIZNI-t Korçë	2	Specialistë/ ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Zyra Rajonale e ALUIZNI-t Shkodër	10	Specialistë/ ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Zyra Rajonale e ALUIZNI-t Lezhë	10	Specialistë/ ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Zyra Rajonale e ALUIZNI-t Vlorë	20	Specialistë/ ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Zyra Rajonale e ALUIZNI-t Fier	16	Specialistë/ ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Zyra Rajonale e ALUIZNI-t Berat	2	Specialistë/ ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
<b>10</b>	<b>Ministria e Financave</b>	<b>18</b>			
	Spektori i pagesave të dëmshpërblimeve	4	Specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Spektori i pagesave të dëmshpërblimeve	1	Arkivistë	8 orë/ditë	vjetore
	Drejtorja e Përgjithshme e Financimeve dhe e Kontraktimeve/dega e thesarit Tiranë	4	Rojë	6 orë/ditë	vjetore
	Degët e thesarit	7	Sanitarë	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Drejtorja e Përgjithshme e Financimeve dhe e Kontraktimeve	1	Sanitarë	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara	1	Sanitarë	4 orë/ditë	vjetore
<b>13</b>	<b>Ministria e Shëndetësisë</b>	<b>15</b>			
	Spitali Psikiatrik Elbasan	2	Kaldajistë	8 orë/ditë	Janar-mars, nëntor-dhjetor
	DSHP Korçë	1	Kaldajist	8 orë/ditë	Janar-mars, nëntor-dhjetor
	DSHP Korçë	2	Operatorë	4 orë/ditë	vjetore
	DSHP Pogradec	1	Punëtor mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
	DSHP Pogradec	1	Operator	4 orë/ditë	vjetore
	ASHR Tiranë	6	Punëtorë mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
	ASHR Tiranë	1	Operator	4 orë/ditë	vjetore
	Aparati	1	Operator	4 orë/ditë	vjetore
<b>14</b>	<b>Ministria e Drejtësisë</b>	<b>6</b>			
	Aparati i Ministrisë	6	Fotokopist	8 orë/ditë	Janar-qershor
<b>18</b>	<b>Shërbimi Informativ Shtetëror</b>	<b>22</b>			
	Shërbimi Informativ Shtetëror	2	Pastruese	4 orë/ditë	6 muaj
	Shërbimi Informativ Shtetëror	5	Kuzhinier	8 orë/ditë	qershor-shtator
	Shërbimi Informativ Shtetëror	3	Banakier	8 orë/ditë	qershor-shtator
	Shërbimi Informativ Shtetëror	12	Pastruese	8 orë/ditë	qershor-shtator
<b>28</b>	<b>Prokuroria e Përgjithshme</b>	<b>4</b>			
	Prokuroria e Përgjithshme	1	Punonjës gjelbërimi	4 orë/ditë	vjetore
	Prokuroria Përmet	1	Pastruese	4 orë/ditë	vjetore
	Prokuroria Durrës	1	Pastruese	4 orë/ditë	vjetore
	Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda	1	Pastruese	4 orë/ditë	vjetore
<b>87</b>	<b>Institucione të tjera</b>	<b>1</b>			
	Agjencia e Prokurimit Publik	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<b>Total numri i punonjësve</b>	<b>415</b>			



**VENDIM**  
**Nr.918, datë 28.12.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS  
PROFESIONALE, ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR PERIUdhËN 1 JANAR-15  
QERSHOR 2012 DHE 15 SHTATOR-31 DHJETOR 2012, PËR MINISTRINË E ARSIMIT  
DHE SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2011-2012 dhe 2012-2013, për periudhën 1 janar-15 qershor 2012 dhe për periudhën 15 shtator-31 dhjetor 2012, të jetë 1 300 (një mijë e treqind) veta.

2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, sipas drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve jepet sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Efektet financiare për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për vitin 2012, në shumën 39 078 000 (tridhjetë e nëntë milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbuloohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në buxhetin e vitit 2012.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Tabela nr.1

Kodi i institucionit	Emërtimi i institucionit arsimor	Punonjës me kontratë të përkohshme për muajin janar 15 qershor 2012	Punonjës me kontratë të përkohshme për periudhën 1 shtator 31 dhjetor 2012
1011002	Drejtoria Arsimore Rajonale Berat	51	51
1011006	Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër	37	37
1011007	Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës	72	72
1011008	Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan	91	91
1011009	Drejtoria Arsimore Rajonale Fier	72	72
1011011	Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastër	21	21
1011015	Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë	60	60
1011018	Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës	32	32
1011020	Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë	32	32
1011033	Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër	76	76
1011035	Drejtoria Arsimore e Qytetit Tiranë	131	131
1011036	Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë	53	53
1011038	Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë	65	65

1011088	Zyra Arsimore Kuçovë	14	14
1011089	Zyra Arsimore Skrapar	13	13
1011090	Zyra Arsimore Bulqizë	16	16
1011092	Zyra Arsimore Mat	28	28
1011096	Zyra Arsimore Krujë	26	26
1011100	Zyra Arsimore Gramsh	19	19
1011101	Zyra Arsimore Librazhd	34	34
1011102	Zyra Arsimore Peqin	13	13
1011105	Zyra Arsimore Lushnjë	57	57
1011106	Zyra Arsimore Mallakastër	15	15
1011109	Zyra Arsimore Përmet	12	12
1011110	Zyra Arsimore Tepelenë	18	18
1011111	Zyra Arsimore Devoll	13	13
1011112	Zyra Arsimore Kolonjë	8	8
1011117	Zyra Arsimore Pogradec	32	32
1011118	Zyra Arsimore Has	9	9
1011120	Zyra Arsimore Tropojë	16	16
1011121	Zyra Arsimore Kurbin	23	23
1011123	Zyra Arsimore Mirditë	16	16
1011124	Zyra Arsimore Malësia e Madhe	17	17
1011125	Zyra Arsimore Pukë	16	16
1011130	Zyra Arsimore Kavajë	31	31
1011132	Zyra Arsimore Delvinë	7	7
1011133	Zyra Arsimore Sarandë	14	14
1011159	Zyra Arsimore Kamzë, Tiranë	40	40
		<b>1300</b>	<b>1300</b>

**VENDIM  
Nr.924, datë 14.12.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.672, DATË 14.9.2011 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË  
STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL”, PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr.8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. Në vendimin nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional”, për vitin 2011-2012, të jenë 9195. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- |   |       |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional” | 8900; |
| b) Kuotat për programe të dyta studimi                                      | 105;  |
| c) Kuotat për transferimin e studimeve                                      | 100;  |
| ç) Kuota për shtetas të huaj  | 50;   |
| d) Kuotat për personat që nuk shikojnë                                      | 20;   |
| dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët                                   | 20.”. |

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

- |   |        |
|---|--------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatët brenda territorit të vendit,        | 8450;  |
| b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatët nga trojet jashtë kufijve të vendit | 450.”. |

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Çdo program studimi i ciklit të dytë “Master profesional”, funksionon në vitin e parë për vitin akademik 2011-2012, në rast se atë e ndjekin të paktën 10 (dhjetë) studentë. Përfundim nga ky rregull bëjnë programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, të ofruara nga Universiteti i Arteve.”.

4. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Tarifat e përgjithshme të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë “Master profesional”, në vitin akademik 2011-2012, përcaktohen sipas kolonës G të tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Pagesa e tarifës bëhet me këste të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së parashikuar të programit të studimit, studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës, paguajnë vetëm tarifën për kredit të lëndëve të prapambetura.”.

5. Tabela nr.1, bashkëlidhur vendimit në fuqi, zëvendësohet me tabelën nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

<b>TABELA NR. 1/1 KUOTAT DHE TARIFAT CIKËL I DYTË “MASTER PROFESIONAL” 2011 - 2012</b>						
<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>	<b>F</b>	<b>G</b>
<b>K_Universiteti</b>	<b>K_ID_ Program</b>	<b>K_Emërtimi_Program</b>	<b>Kuota për student shqiptarë</b>	<b>Kuota studentë nga trojet</b>	<b>Tarifa për kredit 2011-2012 (në lekë)</b>	<b>Tarifa totale për 90 kredite (në lekë)</b>
Universiteti i Tiranës	1	Analizë e Politikës Sociale	50	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	2	Drejtim dhe Administrim Arsimit	50	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	3	Punë Sociale	40	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	4	Punë sociale e avancuar	100	0	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	5	Sociologji edukimi	40	0	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	6	Administrim i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë	50	0	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	7	Pedagogji e specializuar sociale	50	0	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	8	Filozofi Praktike dhe Humane	30	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	9	Qeverisje dhe Politika Publike	50	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	10	Këshillim Psikologjik	40	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	11	Orientim Profesional	40	2	800	72,000
Universiteti i Tiranës	12	Redaktim	100	5	800	72,000
Universiteti i Tiranës	13	Arkivistikë	50	3	800	72,000
Universiteti i Tiranës	14	Histori (Mësuesi)	150	8	800	72,000
Universiteti i Tiranës	15	Gjeografi (Mësuesi)	120	6	800	72,000
Universiteti i Tiranës	16	Gjuhë-Letërsi (Mësuesi)	130	7	800	72,000
Universiteti i Tiranës	17	Fizioterapi	20	1	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	18	Imazheri	20	1	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	19	Mami	40	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	20	Menaxhim Infermieror	150	8	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	21	Teknikë Laboratori	40	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	22	Shëndet Publik	60	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	23	Bioteknologji mjedisore	100	5	900	81,000
Universiteti i Tiranës	24	Informatikë Biznesi	100	5	900	81,000
Universiteti i Tiranës	25	Biznes Law	70	4	800	72,000
Universiteti i Tiranës	26	E Drejtë Penale	60	3	800	72,000
Universiteti i Tiranës	27	E Drejtë Publike	60	3	800	72,000
Universiteti i Tiranës	28	E Drejtë Civile	60	3	800	72,000
Universiteti i Tiranës	29	Administrim - Biznes	50	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	30	Kontabilitet	60	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	31	Financë	115	6	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	32	Menaxhim Turizmi	25	1	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	33	Inxhinieri matematike dhe informatike	40	0	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	34	Menaxhim Turizmi (filiali Sarandë)	30	0	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	35	Studime Ekonomike Europiane	30	2	1,000	90,000





Universiteti i Tiranës	36	Marketing	30	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	37	Marketing dhe marrëdhënie me publikun	30	0	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	38	Administrim - Publik	30	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	39	Sisteme Informacioni në Ekonomi	40	2	1,000	90,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	40	Biznes Blegtoral	30	2	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	41	Cilësia dhe Siguria Ushqimore	100	5	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	42	Mjekësi veterinarë, Profili: Diagnozë Laboratorike	30	2	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	43	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtim "Ekonomi dhe Politikë Agrare"	150	8	800	72,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	44	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtim "Financë-Kontabilitet"	150	8	800	72,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	45	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtim "Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit"	150	8	800	72,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	46	Mjekësi veterinarë, profili: Klinikë Veterinarë	30	2	1,000	90,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	47	Mbrojtja e Bimëve dhe Fitofarmacia	30	2	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	48	Menaxhim Mjedis	60	3	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	49	Teknologji e Avancuar në Hortikulturë	30	2	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	50	Teknologji e Kultivimit të Bimëve	30	2	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	51	Zhvillim rural dhe mjedisor i qendrueshëm	30	0	900	81,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	52	Financë - Kontabilitet	100	5	800	72,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	53	Gjuhë Angleze	40	2	800	72,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	54	Gjuhë - Letërsi AM	30	2	800	72,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	55	Gjuhë - Letërsi CLAB	70	4	800	72,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	56	Marketing	50	3	800	72,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	57	Matematikë - Fizikë	20	1	800	72,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	58	Menaxhim	70	4	800	72,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	59	Shkenca Sociale AM	60	3	800	72,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	60	Turizëm	40	2	800	72,000
Univ."Fan S. Noli"Korçë	61	Zhvillim i Integruar Rural	40	2	800	72,000
Univ. "A. Moisiu"Durrës	62	Administrim Biznes	70	4	800	72,000
Univ. "A. Moisiu"Durrës	63	Administrim Financiar	60	3	800	72,000
Univ. "A. Moisiu"Durrës	64	Administrim Publik	60	3	800	72,000
Univ. "A. Moisiu"Durrës	65	Bankë - Financë	70	4	800	72,000
Univ. "A. Moisiu"Durrës	66	Didaktikë	50	3	800	72,000
Univ. "A. Moisiu"Durrës	67	Drejtim SME	40	2	800	72,000
Univ. "A. Moisiu"Durrës	68	Drejtim Turizmi	40	2	800	72,000
Univ. "A. Moisiu"Durrës	69	Marketing	60	3	800	72,000
Univ. "A. Moisiu"Durrës	70	Mësimdhënie Gjuhë - Letërsi	50	3	800	72,000
Univ.Politeknik i Tiranës	71	Automatizim Industrie	30	2	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	72	Energjitikë	25	1	900	81,000

Univ.Politeknik i Tiranës	73	Inxhinieri e Burimeve Natyrore	45	2	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	74	Inxhinieri Materiale	30	2	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	75	Inxhinieri Gjeodezi	30	23	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	76	Inxhinieri Gjeofizikë	0	0	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	77	Inxhinieri Gjeologjike	60	3	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	78	Inxhinieri Gjeomjedisi	15	1	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	79	Inxhinieri Hidroteknike	25	1	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	80	Inxhinieri Mjedisi	50	3	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	81	Inxhinieri Ndërtimi	90	7	1,000	90,000
Univ.Politeknik i Tiranës	82	Inxhinieri Tekstili dhe Mode	30	2	1,000	90,000
Univ.Politeknik i Tiranës	83	Transport	21	0	900	81,000
Univ.Politeknik i Tiranës	84	Elektroenergjitikë	19	0	900	81,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	85	Mësuesi Matematikë - Fizikë, me profil minor "Informatikë"	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	86	Mësuesi në Biologji e Kimi	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	87	Mësuesi në Edukim Fizik e Sporte	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	88	Mësuesi në Gjuhë Shqipe e Letërsi	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	89	Mësuesi në Histori e Gjeografi	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	90	Mësuesi në Histori e Gjeografi me profil minor në Edukim qytetar	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	91	Mësuesi në Matematikë e Fizikë	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	92	Mësuesi në Matematikë e Informatikë	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	93	Mësuesi në Gjuhën Angleze	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	94	Mësuesi në Gjuhën Frënge	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	95	Mësuesi në Gjuhën Gjermane	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	96	Mësuesi në Gjuhën Italiane	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	97	Mësuesi në Informatikë me profil minor në Matematikë	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	98	Mësuesi në Matematikë me profil minor në Informatikë	60	3	800	72,000
Univ."L.Gurakuqi"Shkodër	99	Përkthim dhe Interpretim në Gjuhën Gjermane	20	1	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	100	Adminstrim Publik	80	4	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	101	Infermier Kirurg	50	3	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	102	Infermier Patolog	100	5	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	103	Infermier Pediatër	50	3	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	104	Shkenca administrative	80	4	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	105	Mësuesi në Gjuhë Angleze	50	3	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	106	Mësuesi në Gjuhë Italiane	50	3	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	107	Mësuesi në Informatikë	30	2	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	108	Mësuesi në Matematikë	30	2	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	109	Mësuesi në Matematikë - Fizikë	50	3	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	110	Operacione Industriale dhe Navale	20	1	800	72,000



Univ."I. Qemali" Vlorë	111	Sipërmarrje në turizëm	80	4	800	72,000
Univ."I. Qemali" Vlorë	112	Studime të Avancuara Detare	20	1	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	113	Administrim Publik	100	5	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	114	Biologji - Kimi	50	3	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	115	Gjuhë Angleze	30	2	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	116	Gjuhë Italiane	30	2	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	117	Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek	30	2	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	118	Gjuhë - Letërsi Shqipe	70	4	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	119	Histori- Gjeografi	80	4	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	120	Kontabilitet - Financë	130	7	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	121	Matematikë - Fizikë	50	3	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	122	Matematikë - Informatikë	60	3	800	72,000
Univ."E.Çabej" Gjirokastër	123	Turizëm	60	3	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	124	Administrim - Biznes	60	3	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	125	Drejtim dhe Administrim Arsimi	80	4	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	126	Ekonomia dhe e Drejta në Sektorin Publik	60	3	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	127	Financë	60	3	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	128	Gazetar Reporter	25	1	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	129	Gazetari Sportive	25	1	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	130	Kontabilitet	60	3	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	131	Marketing	60	3	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	132	Menaxhim Infermieror	100	5	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	133	Mësuesi Biologji - Kimi, me profil minor Edukim Shëndetësor dhe Mjedisor	80	4	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	134	Mësuesi në Edukatë Qytetare me profil minor Gjeografi	50	3	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	135	Mësuesi në Edukatë Qytetare me profil minor Histori	50	3	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	136	Mësuesi në Gjuhë Angleze, me profil minor Gjuhë Shqipe	80	4	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	137	Mësuesi në Gjuhë Frënge me profil minor Gjuhë Shqipe	30	2	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	138	Mësuesi në Gjuhë Italiane, me profil minor Gjuhë Shqipe	35	2	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	139	Mësuesi në Gjuhë Shqipe e Letërsi	80	4	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	140	Mësuesi në Gjuhë Gjermane, me profil minor në Gjuhë Shqipe	25	1	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	141	Mësuesi në Histori - Gjeografi me profil minor Edukatë Qytetare	60	3	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	142	Mësuesi në Matematikë - Fizikë me profil minor Informatikë	70	4	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	143	Mësuesi në Matematikë - Informatikë me profil minor Fizikë	30	2	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	144	Psikologji në Institucione	80	4	800	72,000
Univ."A.Xhuvani" Elbasan	145	Punë Sociale me Fëmijët dhe Familjen	100	5	800	72,000

Univ."A.Xhuvani"Elbasan	146	Redaktim	30	2	800	72,000
Akad. Mbrojtjes "A.Moisiu"	147	Siguri dhe Mbrojtje	50	3	800	72,000
Univ. i Sporteve Tiranë	148	Mësues në AM në Fiskulturë	110	4	800	72,000
Univ. i Sporteve Tiranë	149	Stërvipte Sportive	50	2	800	72,000
Universiteti i Arteve Tiranë	150	Studim Bastubë	2	0	1,250	112,500
Universiteti i Arteve Tiranë	151	Studim kitarë	8	0	1,250	112,500
		<b>TOTALI</b>	<b>8,450</b>	<b>450</b>		

**URDHËR**  
**Nr.483, datë 3.10.2011**

**PËR HAPJEN E FAKULTETIT EKONOMIK NË SHKOLLËN E LARTË PRIVATE**  
**"ILLYRIA"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

- Hapjen, në përputhje me vendimin nr.252, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private "Illyria" të Fakultetit Ekonomik.
- Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe shkolla e lartë private "Illyria". Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**

**URDHËR**  
**Nr.485, datë 3.10.2011**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR",**  
**PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I**  
**SHKENCAVE", SI DHE HAPJEN E FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE TË**  
**ZBATUARA TË EDUKIMIT NË SHKOLLËN E LARTË PRIVATE "JUSTICIA"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 44/1 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

- Hapjen, në përputhje me vendimin nr.232, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private "Justicia", e programeve të studimit të ciklit të dytë "Master profesional" në:



- a) Jurist në administratë;
- b) E drejtë private, me profile:
  - i) E drejtë biznesi;
  - ii) E drejtë tregtare.
2. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.232, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Justicia”, e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në:
  - a) E drejtë civile;
  - b) E drejtë penale dhe shkencat penale;
  - c) E drejtë publike dhe politikat publike;
  - d) Studime në të drejtën europiane.
3. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.253, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Justicia”, të Fakultetit të Shkencave Humane të Zbatuara dhe Edukimit.
4. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.253, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Justicia”, e programeve të studimit të ciklit të parë bachelor në “Studime për zhvillimin human dhe familjen”.
5. Programet e studimeve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në fushën e arsimit të kryer.
6. Programet e studimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në fushën e arsimit të kryer.
7. Programet e studimeve të përcaktuara në pikën 4 të këtij urdhri, realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.
8. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe shkolla e lartë private “Justicia”. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

**URDHËR**  
**Nr.487, datë 4.10.2011**

**PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL DHE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË  
CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË “SHKENCA POLITIKE”, TË INSTITUCIONIT  
PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “SHKOLLA E LARTË “ILLYRIA””**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Akreditimin institucional të Fakultetit të Shkencave Politike të institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e lartë “Illyria”” në përputhje me vendimin nr.242, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në: “Shkenca politike”, në përputhje me vendimin nr.242, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e lartë “Illyria”” të plotësojë rekomandimet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë nr.242, datë 16.9.2011.

4. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e lartë “Illyria””, do t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional dhe të programit të studimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4, neni 62 i ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik, institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e lartë “Illyria””.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**

**URDHËR**  
**Nr.488, datë 4.10.2011**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË**  
**“BACHELOR” DHE PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I**  
**SHKENCAVE” NË “INXHINIERI MEKATRONIKE” NË SHKOLLËN E LARTË**  
**UNIVERSITARE PRIVATE “ALBANIAN UNIVERSITY”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 44/1 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

**URDHËROJ:**

1. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.241, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë universitare private “Albanian University”, e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri mekatronike”.

2. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.241, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë universitare private “Albanian University”, e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Inxhinieri mekatronike”.

3. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor, referuar pikës 1 të këtij urdhri, realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të programit të studimit të ciklit të parë, lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën “Inxhinieri mekatronike”.

4. Programi i studimit i ciklit të dytë “Master i shkencave”, referuar pikës 2 të këtij urdhri, realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike. Në përfundim të



programit të studimit të ciklit të dytë, lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në fushën “Inxhinieri mekatronike”.

5. Shkolla e lartë universitare private “Albanian University”, të dërgojë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, një raport për plotësimin e kushteve të vëna nga Këshilli i Akreditimit në vendimin nr.241, datë 16.9.2011 të tij.

6. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare private “Albanian University”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

**VENDIM**  
**Nr.162, datë 30.12.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR KLIENTËT TARIFORË TË LIDHUR NË TENSION TË LARTË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.80, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

**VENDOSI:**

1. Çmimi i shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët tariforë të lidhur në tension të lartë, do të jetë çmimi i përcaktuar në vendimin nr.100, datë 7.12.2010 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr.10 485, datë 26.11.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, të ndryshuar.

2. Çmimi i energjisë elektrike për energjinë e furnizuar në periudhën e pikut do të jetë 15% më i lartë se ai i furnizuar në periudhën jashtë pikut.

3. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr.82, datë 14.12.2011**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN,  
ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE MBIKËQYRJEN E ZYRAVE TË KËMBIMIT  
VALUTOR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1 pika 4, shkronja “b”; nenit 12 shkronja “b”; nenit 43 shkronja “c”; nenit 61 shkronja “b” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 126 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”, miratuar me vendimin nr.31, datë 6.6.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) përmbajtja e nenit 6, pika 1 ndryshon, si më poshtë vijon:

i) shkronja “a” ndryshon si vijon, cit: “Ekstraktin e regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, për regjistrimin e subjektit si person juridik, në të cilin të jetë e shprehur si objekt i veprimtarisë së shoqërisë, veprimtaria financiare e këmbimeve valutore”;

ii) te nënpika “iii” e shkronjës “b”, pas fjalës “penalisht” shtohen fjalët “ose formularin e vetëdeklarimit, sipas aneksit nr.4 të kësaj rregulloreje”.

iii) pas shkronjës “g” shtohen shkronjat “h”, “i” dhe “j”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

- “h) Deklaratën e nënshkruar nga administratori i personit juridik, sipas aneksit nr.5 të kësaj rregulloreje, mbi njohjen dhe zbatueshmërinë e detyrimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor;

- “i) informacion mbi pajisjet e nevojshme teknike/administrative që zyra disponon për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor, siç listohen në aneksin nr.6, bashkëngjitur dhe pjesë e kësaj rregulloreje;

- “j) informacion mbi mjediset dhe kushtet e sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim. Në këtë dokument jepet informacion minimalisht për instalimin e sistemit të monitorimit dhe të telekamerave, mbi kasafortën për ruajtjen e vlerave monetare, si dhe për ndarjen e zonës së arkës”.

b) përmbajtja e nenit 7 pika 1 shkronja “a” ndryshon si më poshtë vijon:

- “Ekstraktin e regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për regjistrimin e subjektit si person juridik, në të cilin të jetë shprehur si objekt i veprimtarisë së shoqërisë, veprimtaria e agjentit për transferimin e parave në emër dhe për llogari të subjektit financiar jobankë”.

c) Përmbajtja e nenit 9 pika 4 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Në fjalinë e parë hiqen fjalët “të kushteve teknike dhe”;

ii) shfuqizohet fjalia e dytë e kësaj pike.

d) Përmbajtja e nenit 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

i) Në fjalinë e dytë, pas fjalëve “nenit 8, pika 2” shtohet “neni 6 pika 1, shkronja “i” dhe fjalët “kushtet teknike dhe të” zëvendësohen me shkronjën “e””.

e) Përmbajtja e nenit 17 ndryshon si më poshtë vijon:

i) në paragrafin e parë hiqen fjalët “luftës kundër”;





ii) në shkronjën “a”, pas fjalës “klientit” shtohen këto fjalë “sipas dokumentacionit të kërkuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”.

f) Pika e 2 (dytë) e nenit 25 shfuqizohet.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit European dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Ardian Fullani**

**ANEKS NR.4**  
**FORMULAR VETËDEKLARIMI**

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, emri	
Atësia/amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokument i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:  i/e padënuar  i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

\_\_\_\_\_  
Emër, mbiemër/firmë

\_\_\_\_\_  
Emër, mbiemër/firmë/vulë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga Banka e Shqipërisë.

Subjekti i autorizuar

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

\_\_\_\_\_  
Data e nënshkrimit

Shënim.

- Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

- Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

ANEKS NR.5  
DEKLARATË PERSONALE MBI USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËMBIMIT VALUTOR  
ADMINISTRATORI

Shoqëria \_\_\_\_\_ sh.p.k./sh.a.

Nëpërmjet kësaj deklarate synohet rritja e mëtejshme e përgjegjshmërisë së administratorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, në përputhje të plotë me detyrimet ligjore dhe/ose nënligjore, për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor.

Unë, i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, identifikuar nëpërmjet (lloji i mjetit të identifikimit) \_\_\_\_\_ nr. \_\_\_\_\_ dhe me datë lëshimi \_\_\_\_\_, lindur në qytetin e \_\_\_\_\_ dhe me banim në (adresa) \_\_\_\_\_, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, si dhe në rolin e administratorit të shoqërisë “\_\_\_\_\_” sh.p.k./sh.a., me seli (adresa) \_\_\_\_\_, deklaroj nën përgjegjësinë dhe vullnetin tim të lirë se jam i ndërgjegjshëm dhe njohës i përgjegjësive, kërkesave dhe detyrimeve të kuadrit ligjor dhe/ose nënligjor që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor në Republikën e Shqipërisë dhe në veçanti të kërkesave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi, por, pa u kufizuar vetëm në:

- Ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, të cilat mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ([www.fint.gov.al](http://www.fint.gov.al));

- Ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”; rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr.31, datë 6.6.2007, të ndryshuar; rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr.4, datë 10.1.2011; rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr.44, datë 10.6.2009, të cilat mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë ([www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)).

Me respekt,

Z/znj. \_\_\_\_\_

Administrator/i/e shoqërisë “\_\_\_\_\_” sh.p.k./sh.a.

\_\_\_\_\_  
(nënshkrim/firmë, vulë)



ANEKS NR.6  
INFORMACION MBI PAJISJET TEKNIKO-ADMINISTRATIVE

Zyra e këmbimit valutor....., e vendosur në adresën ....., ka krijuar kushtet tekniko-administrative për realizimin e aktivitetit të këmbimit valutor.

Pajisjet tekniko-administrative, që disponon zyra për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lloji i pajisjes	Disponueshmëria e pajisjes
- Kompjuter, printer dhe/ose aksesoret e tyre	✓
- Fotokopje dhe/ose skaner	✓
- Mjete komunikimi (telefon dhe/ose faks, <i>e-mail</i> )	✓
- Makinë të numërimit dhe të verifikimit të parave	✓
- Tabelë e shfaqjes për publikun të kursit të këmbimit	✓
- Faturë tip për veprimet në sportel	✓
- Tabelë e jashtme e shoqëruar me emërtimin ligjor të zyrës	✓

Informacioni i kërkuar sipas nenit 6, pika 1, shkronja “i” të kësaj rregulloreje, mund të shtohet edhe për pajisjet shtesë që zyra disponon, të cilat e ndihmojnë atë (zyrën) në ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor dhe/ose të veprimtarisë së transferimit të parave, në rastet e parashikuara dhe të lejuara nga kjo rregullore.

**VENDIM**  
**Nr.32, datë 14.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK  
PËR SHA UK LEZHË**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

**VENDOSI:**

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. UK Lezhë, si më poshtë:

	<b>Për ujin e pijshëm</b>	<b>Për ujërat e ndotura</b>
Konsumator familjar	50 lek/m <sup>3</sup>	12 lek/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore	115 lek/m <sup>3</sup>	16 lek/m <sup>3</sup>
Ente private	120 lek/m <sup>3</sup>	20 lek/m <sup>3</sup> .
Shitje uji me shumicë	26 lek/m <sup>3</sup>	

2. Tarifë fikse shërbimi 100 lek/muaj/klient.

3. Pagesa rregullatore do të jetë 1 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**  
**Nr.33, datë 14.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK**  
**PËR SHA UK MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

**VENDOSI:**

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. UK Mirditë, si më poshtë:

	<b>Për ujin e pijshëm</b>	<b>Për ujërat e ndotura</b>
Konsumator familjar	30 lek/m <sup>3</sup>	10 lek/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore	100 lek/m <sup>3</sup>	15 lek/m <sup>3</sup>
Ente private	115 lek/m <sup>3</sup>	15 lek/m <sup>3</sup>

2. Pagesa rregullatore do të jetë 0,8 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.  
3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**  
**Nr.34, datë 14.12.2011**

**PËR LICENCIM PËR HERË TË PARË**  
**“NDËRMARRJA UJËSJELLËS, MALËSIA E MADHE” SHA**

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....” Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Të licencohet për herë të parë “Ndërmarrja Ujësjellës Malësia e Madhe” sh.a. operatori me:

- Drejtues ligjor, z. Hajrullah Shaqir Gjekaj.
- Drejtues teknik, z. Sejdi Ali Curri.

2. Operatori “Ndërmarrja Ujësjellës Malësia e Madhe” sh.a. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit e këtij operatori është: bashkia Koplík, komunat Gruemir, Shkrel, Koplík Qendër, Kastrat, Kelmend.



4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri më datë 14.12.2015.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr.35, datë 14.12.2011**

**PËR RINOVIM LICENCE “UJËSJELLËSI FSHAT SHA LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....” Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. T’i rinovohet licenca operatorit “Ujësjiellësi Fshat sh.a. Lushnjë”, me:  
Drejtues ligjor, z. Tafil Sefer Myftari.  
Drejtues teknik, z. Eduart Trifon Tashi.
2. Operatori “Ujësjiellësi Fshat sh.a. Lushnjë” autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:  
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.  
Zona e shërbimit e këtij operatori është: komuna Poshnjë, Libofsh, Fiershegan, Gradisht, Allkaj, Bubullimë, Krutje, Dushk, Kolonjë, Remas, Tërbuf.
3. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri më datë 14.12.2015.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr.36, datë 19.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK  
PËR SHA UK DURRËS**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

**VENDOSI:**

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. UK Durrës, si më poshtë:

	<b>Për ujin e pijshëm</b>	<b>Përujërat e ndotura</b>
Konsumator familjar	58 lek/m <sup>3</sup>	15 lek/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore	110 lek/m <sup>3</sup>	20 lek/m <sup>3</sup>

- |   |                        |                       |
|---|------------------------|-----------------------|
| Ente private  | 120 lek/m <sup>3</sup> | 20 lek/m <sup>3</sup> |
| 2. Tarifë fikse shërbimi  | 100 lek/muaj/klient.   |                       |
| 3. Pagesa rregullatore do të jetë 1 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.                    |                        |                       |
| 4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja. |                        |                       |

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr.37, datë 19.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK  
PËR SHA UK SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

**VENDOSI:**

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. UK Shkodër, si më poshtë:
- |  | <b>Për ujin e pijshëm</b> | <b>Për ujërat e ndotura</b> |
|--|---------------------------|-----------------------------|
| Konsumator familjar  | 40 lek/m <sup>3</sup>     | 15 lek/m <sup>3</sup>       |
| Institucione buxhetore   | 110 lek/m <sup>3</sup>    | 20 lek/m <sup>3</sup>       |
| Ente private   | 110 lek/m <sup>3</sup>    | 20 lek/m <sup>3</sup>       |
| 2. Tarifë fikse shërbimi   | 100 lek/muaj/klient       |                             |
| 3. Pagesa rregullatore do të jetë 0,8 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.                       |                           |                             |
| 4. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja. |                           |                             |

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr.38, datë 21.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK  
PËR SHA UK GJIROKASTËR QYTET**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së



VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. UK Gjirokastrë Qytet, si më poshtë:

	<b>Për ujin e pijshëm</b>	<b>Për ujërat e ndotura</b>
Konsumator familjar	34 lek/m <sup>3</sup>	8 lek/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore	110 lek/m <sup>3</sup>	14 lek/m <sup>3</sup>
Ente private	120 lek/m <sup>3</sup>	14 lek/m <sup>3</sup>
Shitje uji me shumicë (Komuna Antigone)	2.2 lek/m <sup>3</sup>	

2. Tarifa e shërbimit 50 lekë/muaj/klient.

3. Pagesa rregullatore do të jetë 1 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI  
Avni Dervishi

VENDIM

Nr.40, datë 22.12.2011

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK  
PËR SHA UK TIRANË**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. UK Tiranë:

a) Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

	<b>Për ujin e pijshëm</b>	<b>Për ujërat e ndotura</b>
Konsumator familjar	45 lek/m <sup>3</sup>	11 lek/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore	120 lek/m <sup>3</sup>	30 lek/m <sup>3</sup>
Ente private	135 lek/m <sup>3</sup>	35 lek/m <sup>3</sup>
Klientë të veçantë	170 lek/m <sup>3</sup>	40 lek/m <sup>3</sup>

(Prodhim pije alkoolike, freskuese pishina)

Furra buke 95 lek/m<sup>3</sup> 13 lek/m<sup>3</sup>

Shitje uji me shumicë (komuna, bashki) 12 lek/m<sup>3</sup>

Hec Lanabregas 5 lek/m<sup>3</sup>

b)Tarifën mujore fikse të shërbimit 100 lek/klient/muaj.

2. Pagesa rregullatore për sh.a. UK Tiranë do të jetë 1% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**  
**Nr.42, datë 23.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK**  
**PËR SHA “UJËSJELLËS BILISHT”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

**VENDOSI:**

1. Të miratojë për sh.a. “Ujësjiellës Bilisht”:

a) Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

**Për ujin e pijshëm**

Konsumator familjar 38 lek/m<sup>3</sup>

Institucione buxhetore 100 lek/m<sup>3</sup>

Ente private 110 lek/m<sup>3</sup>

b) Tarifën mujore fikse të shërbimit 50 lek/klient/muaj.

2. Pagesa rregullatore për sh.a. “Ujësjiellës Bilisht” do të jetë 0,8 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**  
**Nr.43, datë 23.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK**  
**PËR SHA UK KORÇË**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së





VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. UK Korçë:

a) Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

	<b>Për ujin e pijshëm</b>	<b>Për ujërat e ndotura</b>
Konsumator familjar	60 lek/m <sup>3</sup>	30 lek/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore	105 lek/m <sup>3</sup>	50 lek/m <sup>3</sup>
Ente private	140 lek/m <sup>3</sup>	50 lek/m <sup>3</sup>

b) Tarifën mujore fikse të shërbimit 100 lek/klient/muaj.

2. Pagesa rregullatore për sh.a. UK Korçë do të jetë 1,5% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI  
Avni Dervishi

VENDIM

Nr.44, datë 23.12.2011

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK  
PËR SHA “UJËSJELLËS ELBASAN FSHAT”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. “Ujësjellës Elbasan Fshat”:

a) Tarifat e ujit për konsum publik si më poshtë:

	<b>Për ujin e pijshëm</b>
Konsumator familjar	36 lek/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore:	110 lek/m <sup>3</sup>
Ente private	110 lek/m <sup>3</sup>
Çezma publike	30 lek/m <sup>3</sup>
Shitje uji me shumicë	
Komuna Gostimë	25 lek/m <sup>3</sup>
Komuna Shushicë	6 lek/m <sup>3</sup>

b) Tarifën mujore fikse të shërbimit 100 lek/klient/muaj.

2. Pagesa rregullatore për sh.a. “Ujësjellës Elbasan Fshat” do të jetë 0,8 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr.45, datë 26.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHITJES SË UJIT ME SHUMICË (KOMUNËS  
DROPULL I POSHTËM) PËR SHA “UJËSJELLËS GJIROKASTËR FSHAT”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

**VENDOSI:**

1. Të miratojë për sh.a. “Ujësjiellës Gjirokastër Fshat”:  
Tarifë për shitjen e ujit me shumicë: 1.8 lek/m<sup>3</sup>.
2. Pagesa rregullatore për sh.a. “Ujësjiellës Gjirokastër Fshat” do të jetë 0,8 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.
3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**  
**Nr.46, datë 26.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK  
PËR SHA “UJËSJELLËS ORIKUM”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

**VENDOSI:**

1. Të miratojë për sh.a. “Ujësjiellës Orikum”:
  - a) Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

	<b>Për ujin e pijshëm</b>
Konsumator familjar	25 lek/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore:	70 lek/m <sup>3</sup>
Ente private	75 lek/m <sup>3</sup>
  - b) Tarifën mujore fikse të shërbimit 100 lek/klient/muaj.
2. Pagesa rregullatore për sh.a. “Ujësjiellës Orikum” do të jetë 0,8 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.
3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**



**VENDIM**  
**Nr.47, datë 26.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK**  
**PËR SHA “UJËSJELLËS SHKODËR FSHAT”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

**VENDOSI:**

1. Të miratojë për sh.a. “Ujësjiellës Shkodër Fshat”:

a) Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

**Për ujin e pijshëm**

Konsumator familjar	50 lek/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore	120 lek/m <sup>3</sup>
Ente private	120 lek/m <sup>3</sup>
b) Tarifë për shitjen e ujit me shumicë	9 lek/m <sup>3</sup> .

2. Paguesa rregullatore për sh.a. “Ujësjiellës Shkodër Fshat” do të jetë 0,8 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr.1737, datë 1.12.2011, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetases Neriman Karagjozi, e bija e Avdulit, e datëlindjes 1930, banuese në Gjirokastrë.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 26.1.2012  
Doli nga shtypi më 28.1.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë